REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 539/26 Dt. 17.11.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të Rregullores (QRK) nr. 06/2023 për Kompensimin për Udhëtime Zyrtare dhe Shpenzime të Përfaqësimit dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
Për lejimin e udhëtimit zyrtar

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i Kujtim Gashit, nënkryetar i Komunës së Prizrenit, bazuar në ftesën e drejtorit ekzekutiv të CNM ingenuity me bazë në Albuqueque, New Mexico-Shtete e Bashkuara të Amerikës, për realizimin e një vizite zyrtare nga data 30 nëntor 2026 deri me 4 dhjetor 2026, me qëllim të thellimit të bashkëpunimit dhe partneritetit të suksesshëm me Makerspace Innovation Center (MICP), veçanërisht pas nisjes së programeve tona të licencuara të trajnimit në fushën e Shkencës së të Dhënave (Data Sciene) në Kosovës.

2. Në kuadër të kësaj vizite do të shqyrtohet mundësia e bashkëpunimit me Bashkinë e Albuqueque dhe partnerët rajonal, me fokus të trajnimi i fuqisë punëtore, sipërmarrja, inovacioni dhe mundësit për zgjerim të partneritetit ekzistues, përfshirë rinovimin e mundshëm të Memorandumit të Mirëkuptimit.

3. Nisja (shkuarja) zyrtare do të bëhet me datën, 27 nëntor 2026 dhe kthimi me 05 dhjetor 2026, kështu që, për këtë qëllim lejohen mjetet e nevojshme për: mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit, ushqimit, akomodimit, pagesa e mëditjeve, si dhe për shpenzime të paparashikuara, për të lartcekurit.

4. Shuma e lejuar, e përshkruar si në këtë Vendim, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Zyrës së Kryetarit dhe Komunës së Prizrenit.

5. Obligohet Kabineti i Kryetarit të Komunës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Të lartcekurit,
- Arkivës së Kryetarit.